

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21 dhe 154/23), dhe në lidhje me nenin 141 paragrafi (13) nga Ligji i njëjtë, pika 8 dhe pika 14 e Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencia për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.1102-742/1 datë 15.02.2024 dhe Konkluzionin ark.nr. 0201-773/3, datë 19.02.2024, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 6-të mbajtur më 19.02.2024, miratoi si vijon:

**Aktvendim
për paralajmërim publik dhe përjashtim të ritransmetimit të shërbimit programor**

1. **PUBLIKISHT PARALAJMËROHET** Operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik, Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime TELENET KOM SHPK eksport-import, Tetovë, sepse ka ritransmetuar shërbim programor i cili nuk ishte i regjistruar në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia) në pajtim me nenin 141 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV).

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.1102-742/1 datë 15.02.2024, që është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1 .

2. **URDHËROHET** që Operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik, Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime TELENET KOM SHPK eksport-import, Tetovë, menjëherë pas pranimit të këtij aktvendimi, të harmonizon punën e tij me dispozitat e LSHMAAV, pra të ndërpres me ritransmetim të shërbimit programor.

3. Të kryehet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi ka vepruar sipas aktvendimit për paralajmërim publik dhe për ndërprerje me ritransmetim të shërbimit programor.

4. Nëse subjekti i mbikëqyrjes nga pika 1 e këtij aktvendimi, nuk vepron sipas aktvendimit, pra vazhdon me shkeljen për të cilën është paralajmëruar publikisht, Agjencia, në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 2 të LSHMAAV, do të paraqesë kërkesë për iniciimin e procedurës për kundërvajtje para gjykatës kompetente.

5. Ky aktvendim është përfundimtar dhe dita e miratimit të tij llogaritet dita e çertifikimit në arkivin e Agjencisë.

A r s y e t i m

Agjencia në pajtim me nenin 6 paragrafi (1) nënparagrafi 4 nga LSHMAAV, ndërmerr masa në në përputhje me këtë ligj në rastet kur ka shkelje të dispozitave të LSHMAAV ose të rregulloreve të miratuara në bazë të tij dhe kushteve dhe detyrimeve nga lejet.

Në bazë të nenit 28 të LSHMAAV, Agjencia është kompetente për të kryen mbikëqyrje kontrolli (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë, si dhe të paketave programore që ritransmetohen nga operatorët e rrjetet publike të komunikimit elektronik nga aspekti i respektimit të dispozitave të këtij ligji, lejeve, çertifikatave të dhëna për regjistrim, aktet nënligjore dhe aktet e tjera të miratuara nga Agjencia.

Në kuadër të kompetencave të saj ligjore dhe në përputhje me nenin 27 dhe nenin 28 të LSHMAAV, Agjencia më 13.02.2024, ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore të paketës programore të ritransmetuar nga operatori Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime TELENET KOM SHPK eksport-import, Tetovë, nga ku është konstatuar se operatori në fjalë, i cili sipas njoftimit nga Agjencia për Komunikim Elektronik mund të kryejë veprimtari në territorin e komunës së Tetovës, për shfrytëzuesit e tij ka ritransmetuar shërbim programor, që nuk mbulohet me çertifikatë për regjistrim të shërbimit programor të dhënë nga Agjencia, e cila është në kundërshtim me nenin 141 të LSHMAAV. Konstatimet nga mbikëqyrja janë të specifikuar në mënyrë të detajuar në Raportin me shkrim për

mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.1102-742 /1 datë 15.02.2024, që është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Rrjedhimisht nga sa mësipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 141 paragrafi (13) nga Ligji i njëjtë, pika 8 dhe pika 14 e Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës, Raporti me Shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.1102-742 /1 datë 15.02.2024 dhe Konkluzionin ark.nr.0201-773/3, datë 19.02.2024, për shkak të konstatimit të mosrespektimit të dispozitave të LSHMAAV të përcaktuara në pikën 1 të këtij aktvendimi, Këshilli i Agjencisë, ka marrë vendim me të cilin ndaj subjektit në fjalë është ndërmarrë masë paralajmërim publik dhe urdhërohet menjëherë pas pranimit të aktvendimit që të harmonizojë punën e tij me dispozitat e LSHMAAV, në mënyrë që do të ndërpres me ritransmetim të shërbimit programor.

Agjencia do të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti në fjalë ka vepruar sipas urdhërit, pra sipas paralajmërimit publik dhe ka ndërprerë me ritransmetim të shërbimit programor.

Në pajtim me nenin 24 të LSHMAAV, ky aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij aktvendimi operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Bazuar në sa më sipër u miratua aktvendim si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

- Raport me shkrim mbi mbikëqyrjen e kryer programore, ark.nr.1102-742/1 datë 15.02.2024.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.